



KALENDARI AKTIVITETEVE

2020

KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË



Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Aktivitete 2020

Editor
Erzen Carja

Dizajn
Erzen Carja

ISBN 978-9928-194-87-9

Tiranë 2021

Adresa:
Rr. George W. Bush, nr. 50, Tiranë

Tel: (+355) 42 230 492
info@kmsh.al
www.kmsh.al



Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është një institucion me traditë në Shqipëri, themelimi zyrtar i të cilit daton më 1923 dhe për t'u rihapur më 1990.

Në ushtrimin e veprimtarisë së tij, si një institucion fetar e bamirës, ka si qëllim të përhapë, zgjojë dhe forcojë tek të gjithë, besimin islam, të ruajë traditën e trashëguar nga të parët tanë, të mbrojë dinjitetin, të drejtat dhe interesat e myslimanëve, të rrisë e zhvillojë ndjenjën e dashurisë e të besnikërisë ndaj fesë dhe atdheut, si dhe të ruajë e forcojë dialogun mes Komuniteteve Fetare në vendin tonë.

Në këtë botim të KMSH-së do të gjeni informacione rreth aktiviteteve kryesore dhe evenimenteve të ndryshme të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë gjatë vitit 2020. Natyrisht që përfshirja e të gjithë aktivitetit të institucionit tonë, duke përfshirë myftinitë dhe institucionet arsimore-edukative, në një vëllim të tillë do të ishte e pamundur. Prandaj, institucionet arsimore dhe myftinitë kryesore të vendit e pasqyrojnë aktivitetin e tyre në botime të veçanta.

Gjejmë rastin të falënderojmë të gjithë institucionet publike dhe jopublike, brenda dhe jashtë vendit, që nuk e kanë kursyer ndihmën dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.

Gjithashtu shprehim gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe për të qenë pjesë e të gjitha aktiviteteve dhe nismave në të mirë të vendit tonë dhe të shoqërisë njerëzore në përgjithësi.

Formatin online të këtij botimi mund ta gjeni në faqen zyrtare të institucionit: www.kmshe.al

Zhvillohet trajnimi me temë: “Mirëdrejtimi dhe Marketingu për Zhvillimin e Vakëfeve”

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, përshëndeti trajnimin 3 ditor, me temë: “Mirëdrejtimi dhe Marketingu për Zhvillimin e Vakëfeve”.

Ky trajnim, në të cilin morën pjesë një numër i konsiderueshëm myftinjsh, imamësh dhe administratorësh nga vendi ynë, Kosova dhe Mali i Zi, u organizua nën kujdesin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe nga Komiteti i Bashkuar Kuvajtjan për Bamirësi në bashkëpunim me Institutin Islamik për Kërkime dhe Trajnime dhe Fondacionin Publik Awqaf.







Ambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë viziton KMSH-në

Ambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë, z. Abdul-Mu'min Muhamed Sharaf, i shoqëruar nga një delegacion përfaqësuesish, të përbërë nga Konsulli i Ambasadës, z. Hatim el-Sa'di dhe Përgjegjësi i Çështjeve Fetare, z. Hamed el-Saj'arij, zhvilluan një vizitë kortezie në selinë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, ku u pritën nga Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, bashkë me stafin e institucionit.

Gjatë bashkëbisedimit ndërmjet tyre u diskutua mbi aktualitetin e deritanishëm të të dy institucioneve, mbi bashkëpunimet dhe marrëdhëniet e mira institucionale mes Ambasadës dhe KMSH-së.



Mbledhja e parë e Bordit të Presidencës së Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë për vitin 2020

Në mbledhjen e zhvilluar, merrnin pjesë krerët e pesë komuniteteve fetare në vend, të cilët diskutuan mbi raportin një vjeçar të KNFSH-së.

Anëtarët e Këshillit të Presidencës gjatë kësaj mbledhjeje kanë diskutuar edhe për disa çështje të rëndësishme lidhur me angazhimet e KNFSH-së në vazhdimësi.



Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, viziton Myftininë e Vlorës

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, sëbashku me kancelarin, z. Ylli Cikalleshi, zhvilluan një vizite pune në Myftininë e Vlorës, ku u pritën nga Myftiu, z. Bilal Bodlli dhe imamët e qytetit.

Gjatë takimit u diskutuan një sërë çështjesh aktuale të kësaj myftinie, përmendim këtu menaxhimin e vakëfeve të këtij qyteti, punën e përditshme të imamëve në përcjelljen e mesazhit Islam, aktivitetet, projektet dhe nismat e ndërmarra deri më tani nga kjo myftini.



Myftiu i Elbasanit vlerësohet me titullin: “Mirënjohja e Qarkut Elbasan”

Ky titull ju akordua Myftiut të Elbasanit gjatë një ceremonie të zhvilluar në ambientet e Hotel “Skampa”, ku ishin të pranishëm Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Kryetari i Bashkisë së Elbasanit, z. Gledian Llatja, përfaqësues të komuniteteve të tjera fetare të Elbasanit, përfaqësues të pushtetit vendor e lokal, myftinj, qytetarë dhe intelektualë të shumtë të këtij rrethi.

Në fjalën e tij përshëndetëse, kryetari i KMSH-së, z. Spahiu, pasi falënderoi Këshillin e Qarkut Elbasan për vlerësimin e Myftiut të këtij rrethi, u ndal në promovimin e vlerave dhe parimeve më të larta shoqërore që janë në thelb të institucionit të KMSH-së dhe myftinive në rrethe.



Zyra e Gruas zhvillon mbledhjen e parë për vitin 2020

Takim periodik pune i përgjegjëses së zyrës së gruas pranë KMSH-së, znj. Fatma Karaj, me stafin e saj mbështetës.

Gjatë këtij takimi u diskutua ecuria e vitit të kaluar e kësaj zyre dhe të zyrave të ngjashme në çdo myftini të vendit si dhe u ndanë objektivat për vitin në të cilin sapo kemi hyrë.



Kryetari i KMSH-së mban hutben në xhaminë e “Medresesë”, Tiranë

Tema e referimit për dhjetëra besimtarët e pranishëm ishte shfrytëzimi i 3 muajve të begatë, Rexheb, Shaban dhe Ramazan.

Në referimin e tij ai u fokusua në veçoritë, adhurimet, rëndësinë e leximit të Kuranit, netët e mira dhe në tërësi sjelljen apo mënyrën sesi duhet t'i presin e t'i përcjellin besimtarët këto 3 muaj të begatë.





Zhvillohet konferenca rajonale me temë: “Vëllazëria njerëzore për promovimin e sigurisë dhe paqes”

Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, sëbashku me Myftiun e Tiranës, z. Lauren Luli dhe Drejtorin e Vakf-Investimeve në KMSH, z. Edison Hoti, morën pjesë në konferencën rajonale, me temë: “Vëllazëria njerëzore për promovimin e sigurisë dhe paqes”.

Konferenca u organizua në Zagreb, Kroaci, nga Liga e Botës Islame në bashkëpunim me Komunitetin Mysliman të Kroacisë, punimet e saj u zhvilluan në datat 4 dhe 5 shkurt 2020.



Kryetari i KMSH-së, vizitë pune në Myftininë e Beratit

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, sëbashku me Nënkryetarin, z. Taulant Bica, zhvilluan një vizite pune në Myftininë e Beratit, ku u pritën nga Myftiu, z. Baftjar Këllezi dhe imamët e rrethit.

Gjatë vizitës në ambientet e myftinisë, u diskutua mbi çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me problematikat e përditshme administrative, menaxhimin e vakëfeve, organizmin dhe aktivitetet fetare.

Kryetari Spahiu, vlerësoi angazhimin e përditshëm të Myftiut dhe imamëve në përmbushjen e objektivave dhe përcjelljen e mesazhit Islam tek të gjithë besimtarët. Kryetari mbajti edhe hutben e javës në qytetin e Beratit.



Frytet e Besimit zhvillohen në xhaminë e Pazarit të Ri, Tiranë

Kryetari Spahiu ndau ligjëratën e rastit me besimtarët e xhamisë ku edhe ai prej vitesh është xhemat.

Ai referoi mbi singeritetin që duhet të ekzistojë mes fjalës dhe veprës së besimtarit, duke e ilustruar fjalimin e tij me ajete të shumtë nga Kur’ani fisnik.

Sipas tij, singeriteti dhe veprat e mira janë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën, pasi një besimtar i vërtetë mysliman nuk mund ta konceptojë dhe ndërtojë jetën e tij pa nijetin e pastër në veprimin e çdo pune në jetën e tij të përditshme.



Kryetari Spahiu merr pjesë në aktivitetin e ditës së pavarësisë dhe të çlirimit të shtetit të Kuvajtit

Në kuadër të ditës së pavarësisë dhe të çlirimit të shtetit të Kuvajtit, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në aktivitetin e organizuar me këtë rast nga Ambasada e Kuvajtit në ambientet e “Hotel Tirana”.

Pasi uroi ditën e pavarësisë dhe çlirimit, Kryetari Spahiu u ndal në kontributin e shtetit të Kuvajtit nëpërmjet fondacioneve në ndërtimin e xhamive në mbarë vendin, ndihmën në kauzën e fëmijëve jetimë, si dhe kontribute e bamirësi të ndryshme.



Nënkryetari i KMSH-së mban hytben e xhumasë në xhaminë e qendrës, Fier

Në referimin e tij për dhjetëra besimtarët e pranishëm, Nënkryetari i KMSH-së, z. Taulant Bica, u ndal mbi jetën e Profetit Muhamed (a.s) si shembullin më të përkryer në përditshmërinë e besimtarit.

Duke e ilustruar fjalimin e tij me ajete të shumtë nga Kur’ani fisnik, ai ndau me të pranishmit mëshirën, moralin, drejtësinë, urtësinë dhe mjaft cilësi të tjera të Profetit tonë të dashur.



Ambasadori i Gjermanisë në Tiranë, viziton KMSH-në

Ambasadori i Gjermanisë në Tiranë, z. Peter Zingraf, vizitoi Komunitetin Mysliman të Shqipërisë ku u prit nga kryetari, H. Bujar Spahiu, Nënkryetari, z. Taulant Bica dhe Drejtori i Marrëdhënieve me Jashtë, z. Fejzi Shaholli.

Gjatë bashkëbisedimit, Kryetari Spahiu e prezantoi atë me institucionin, rolin e tij në tolerancën dhe harmoninë ndërfetare, sistemin arsimor të medreseve, universitetin dhe kontributin e deritanishëm të KMSH-së në shoqëri.

Ndërsa Ambasadori, z. Zingraf, vlerësoi qëndrimet e Komunitetit Mysliman ndër vite, rolin e tij si faktor rregullues në shoqërinë shqiptare.




Një delegacion i Bashkësisë Islame të Kosovës, viziton KMSH-në

Një delegacion nga Bashkësia Islame e Kosovës, i kryesuar nga Kryeimami, Sabri ef. Bajgora, vizitoi KMSH-në, ku u prit nga Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu.

Bashkëbisedimi ndërmjet palëve u fokusua mbi bashkëpunimin e deritanishëm në fushën e medias, kulturës, botimeve, etj.

Gjatë këtij takimi ishin të pranishëm gjithashtu edhe përfaqësues të tjerë të lartë të të dy institucioneve.



Islami dhe sfidat e familjes në shoqërinë bashkëkohore

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Islame pranë Kolegjit Universitar “Bedër”, dhe Këshillin Botëror të Komuniteteve Myslimane, zhvilluan Konferencën e Tretë Ndërkombëtare në Studimet Islame, me temë: “Islami dhe sfidat e familjes në shoqërinë bashkëkohore”.

Kjo konferencë mbledhi së bashku mbi 20 akademikë dhe studiues, të cilët në referimet e tyre u fokusuan në trajtimin e temave të ndryshme rreth rolit, rëndësisë dhe sfidave që familja po përballët çdo ditë.







Zyra e Gruas organizon program festiv për 7 marsin 2020

Zyra e Gruas në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, në kuadër të festës së 7 marsit, zhvilloi një program festiv që mbledhi sëbashku mësuese nga të gjitha medresetë e vendit.

Programin e përshëndeti edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili gjatë fjalës së tij, foli mbi detyrën fisnike të mësuesisë dhe rëndësisë së arsimit dhe edukimit tek brezat e rinj.

Ndërsa, znj. Fatma Karaj, Përgjegjësjë e Zyrës së Gruas pranë KMSH-së, në fjalën e saj u përqendrua në punën e përditshme të mësuesve, duke e theksuar atë si një mision fisnik në pajisjen e brezave të rinj me njohuri.







Kreu i KMSH-së zhvillon një bashkebisedim online me Ambasadoren e SHBA-ve

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Bujar Spahiu ka zhvilluar një takim online me Ambasadoren e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, znj. Yuri Kim.

Gjatë këtij takimi online, kryetari KMSH-së, i uroi znj. Kim mirëseardhjen në Shqipëri dhe suksese në detyrën e saj të re.

Në vijim, z. Spahiu, e njohu ambasadoren Kim me historikun e KMSH-së, ecurinë e tij gjatë këtyre viteve, sfidat e institucionit si dhe rrjetin arsimor të KMSH-së, me medresetë dhe Universitetin Bedër.

Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, znj. Yuri Kim, falënderoi z. Spahiu dhe shprehu konsideratën e saj të lartë për institucionin, vlerat që përfaqëson dhe rolin që luan në Shqipëri.









Mbarë besimtarët myslimanë falin Fitër Bajramin

Falja e Fiter Bajramit në xhaminë e Kokonozit, 24 maj 2020, Tiranë.

Namazi i faljes së Bajramit të Madh u drejtua nga Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu.

Kujtojmë se Falja e Bajramit u zhvillua në kushtet e distancimit të imponuara nga pandemia globale COVID-19.









Kreu i KMSH-së pret në takim ambasadoren e Greqisë

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një vizitë në selinë e KMSH-së, Ambasadoren e Greqisë në Shqipëri, znj. Sophia Philippidou.

Kryetari Spahiu e prezantoi atë me institucionin, rolin e tij në tolerancën dhe harmoninë ndërfaqetare, sistemin arsimor të medreseve, universitetin, dhe kontributin e deritanishëm të KMSH-së në shoqëri.

Ambasadorja znj. Philippidou, vlerësoi rolin aktiv të KMSH-së në promovimin e vlerave, angazhimin e treguar në raport edhe me bashkësitë e tjera fetare në vend dhe rajon si dhe rolin e KMSH-së si faktor rregullues në shoqërinë shqiptare.

Më pas u diskutua edhe mbi mundësitë e bashkëpunimit ndërinstitucional.



Kreu i KMSH-së pret në një takim përfaqësuesit e tarikateve

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në selinë e KMSH-së, përfaqësuesit zyrtar të Tarikatit Rifai, Sheh Qemaludin Reka dhe të Tarikatit Kadiri, Sheh Bujar Horasani.

Gjatë bashkëbisedimit, përfaqësuesit e këtyre tarikateve që njihen zyrtarisht nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, u përqëndruan në çështjet e përgjithshme me të cilat ata përballen në përditshmërinë e aktiviteteve të tyre.

Intensifikimi i bashkëpunimit të mëtejshëm ndërmjet dy palëve ishte një ndër pikat e shumta që u trajtuan më tej gjatë këtij takimi.



Kreu i KMSH-së pret në një takim përfaqësuesin zyrtar të Tarikatit Halveti

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë,
H. Bujar Spahiu, priti në selinë e institucionit,
përfaqësuesin zyrtar të Tarikatit Halveti, Sheh Hysen
Hormova.

Gjatë bashkëbisedimit, z. Hormova, u përqendrua
në organizimin e tarikatit dhe veprimtarisë së tij të
përditshme si drejtues i këtij të fundit.

Më tej ai u ndal në rindërtimin e xhamisë së fshatit
Hormovë të Tepelenës nga besimtarët në vitin 2018,
xhami kjo e ndërtuar për herë të parë në vitin 1872
dhe e përdoruar më pas, në vitin 1921, si shkollë e
parë shqipe nga mësuesi Ali Sheh Hormova.

Më tej, biseda ndërmjet Kryetarit Spahiu dhe z.
Hormova u fokusua në bashkëpunimin e mëtejshëm
dypalësh.



Besimtarët myslimanë festojnë Kurban Bajramin

Tiranë, më 31 korrik 2020, e premte.
Besimtarët myslimanë falën namazin e Kurban Bajramit në të gjitha xhamitë e vendit.

Ceremonia kryesore, ku ishte i pranishëm edhe kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, u zhvillua në xhaminë e “Kokonozit” (Pazari i ri), Tiranë.

Ashtu si falja e Fitër Bajramit edhe Kurban Bajrami, këtë vit u zhvillua në të gjithë vendin duke respektuar një protokoll të caktuar, në kuadër të parandalimit të përhapjes së mëtejshme të COVID-19.









Inaugurohet xhamia e re e fshatit Banaj, Berat

Në ceremoninë e inaugurimit të kësaj xhamie ishin të pranishëm: Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Drejtori i Vakf-Investimeve, z. Edison Hoti, Myftiu i Beratit, z. Bafjar Këllezi, Myftiu i Lushnjës, z. Gramoz Blliku, Kryetari i Fondacionit “Mirënjohja”, z. Samed Shehu si dhe dhjetëra besimtarë të zonës.

Kryetari i KMSH-së, z. Spahiu, ndau me të pranishmit mirënjohjen ndaj të gjithë atyre që bënë të mundur ndërtimin e kësaj xhamie. Ai gjithashtu theksoi se xhamia është një vatër edukimi dhe në themelin e saj qëndron dashuria, respekti dhe adhurimi i Allahut.

“I lutem Zotit që kjo xhami të frekuentohet nga besimtarët e zonës, të shërbejë për të ushqyer mendjen, shpirtin dhe zemrën me adhurim dhe besimin e bukur Islam” – tha ai gjatë fjalës së tij.







Inaugurohet qendra kulturore fetare në Lushnje

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në inaugurimin e qendrës kulturore të Myftinisë së Lushnjës.

Në këtë ceremoni ishin gjithashtu të pranishëm Myftiu i Lushnjës, z. Gramoz Blliku, Kryetari i Bashkisë së këtij qyteti, z. Fatos Tushe, Kryetari i Shoqatës “Mirënjohja”, z. Samed Shehu, si dhe dhjetëra besimtarë.

“Ndërtimi i qendrave të tilla është shumë i domosdoshëm për qytetin, pasi ato rigjallërojnë jetën kulturore e fetare të vendit nëpërmjet kurseve apo aktiviteteve që mundësojnë për grupmosha të ndryshme”- tha z. Spahiu gjatë fjalës së tij.

Qendra u financua nga shteti i Kuvajtit nëpërmjet Fondacionit “Mirënjohja”.







Kryetari i KMSH-së vlerësohet me certifikatë mirënjohjeje nga Bashkia Lushnje

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, u vlerësua nga Kryetari i Bashkisë së Lushnjës, z. Fatos Tushe, me Certifikatë Mirenjohjeje, me motivacionin: “Për kontributin e madh që ka dhënë duke iniciuar dhe mbështetur investime të shumta në interes të komunitetit të Lushnjës. Vepra e tij humanitare, sidomos me çeljen e Qendrës Multifunksionale të aftësimit profesional, tregon dashurinë e veçantë të z. Spahiu për brezin e ri”.

Ky vlerësim i'u dorëzua Kryetarit Spahiu gjatë inaugurimit të qendrës kulturore të Myftinisë së Lushnjës nga vetë Kryetari i Bashkisë, ku gjithashtu ishte i pranishëm Myftiu i këtij qyteti, z. Gramoz Blliku.



Inaugurohet restaurimi i Xhamisë së Peqinit

Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, sëbashku me Drejtorin e Vakf-Investimeve, z. Edison Hoti, Myftiun e Peqinit, z. Mensur Rrapanji dhe Nënkryetaren e Shoqatës “Shtëpia e Bamirësisë”, znj. Anisa Kita, inaugurojnë resturimin e xhamisë së qendrës së Peqinit, “Abdurrahman Pasha”.







Zhvillohet simpoziumi ndërkombëtar (online) me temë: “Roli i Institucioneve Bamirëse në Promovimin e Pages Sociale”

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në bashkëpunim me Këshillin Botëror të Komuniteteve Myslimane dhe Kolegjin Universitar “Bedër”, zhvilluan Simpoziumin Ndërkombëtar (Online) me temë: “Roli i Institucioneve Bamirëse në Promovimin e Pages Sociale”.

I zhvilluar nëpërmjet platformës online (zoom), ky simpozium mbledhi sëbashku liderë fetarë, drejtues institucionesh, akademikë dhe besimtarë të shumtë nga vende të ndryshme të botës, veçojmë këtu folësin kryesor të këtij simpoziumi, H. E. Dr. Hamdan Almazrouei, Kryetar i Bordit të Drejtorëve, “Gjysmë Hëna e Kuqe e Emirateve të Bashkuara Arabe”, Dr. Mohamed Beshari, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane, Kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Rektorin e Kolegjit Universitar “Bedër”, Prof. Dr. Ferdinand Gjana, si dhe Msc. Hysni Skura, pedagog në të njëjtin institucion arsimi, modëtaror i këtij simpoziumi.



Qëllimet e larta të paqes në Islam

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, merr pjesë në Konferencën ndërkombëtare, me temë: “Qëllimet e larta të paqes në Islam”, e organizuar online nga Këshilli Botëror i Komuniteteve Myslimane në Abu Dabi.

Të pranishëm në këtë konferencë ishin Dr. Ali Rashid al-Nuajmi, Kryetari i (KBKM), Dr. Muhamed Muhtar Xhuma, Ministri Egjiptian i Vakfeve, Dr. Muhamed Matar al-Kaabi, Ministër i Çështjeve Islame dhe Vakfeve në Emiratet e Bashkuara Arabe, personalitete dhe drejtues fetarë nga vende të ndryshme të botës.



Roli i Tolerancës Fetare në parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm

Komiteti Shqiptar i Helsinkit zhvilloi workshopin, me temë: “Roli i Tolerancës Fetare në parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm”.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësuesit e komuniteteve fetare të vendit, ndër ta edhe Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, z. Genti Kruja, Përfaqësuesja e Komitetit Shqiptar të Helsinkit njëkohësisht edhe moderatorja e këtij workshopi, znj. Miriam Neziri Angoni, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, etj.







Inaugurohet fillimi i punimeve të xhamisë së re të Saukut

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, sëbashku me Ambasadorin e Shtetit të Kuvajtit në Shqipëri, z. Fayez Mishari Al-Jassim, Myftiun e Tiranës, z. Lauren Luli, Drejtorin e Vakf-Investimeve në KMSH, z. Edison Hoti dhe Drejtorin e Fondacionit Mirënjohja, z. Samed Shehu, marrin pjesë në fillimin e punimeve të xhamisë së re të Saukut.

Gjatë bashkëbisedimit me të pranishmit Kryetari Spahiu falënderoi kontribuesit, bashkëpunëtorët dhe të gjithë faktorët e tjerë të cilët vunë në jetë themelet e një tjetër xhamie për kryeqytetin, e cila do të shërbejë jo vetëm si vend adhurimi ndaj Allahut (xh.sh) por edhe si një vatër edukimi me vlerat e larta të Islamit.









Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë uron vitin e ri shkollor 2020-2021

“Sot është një ditë e shënuar për fëmijët tanë, gjithashtu edhe mësuesit! Si asnjëherë më parë në memorien tonë kolektive kjo ditë nis ndryshe. Fëmijët tanë dhe mësuesit do të jenë të shtrënguar të punojnë në masa të rrepta distancimi fizik, gjë e cila ndodh për herë të parë, dhe si e tillë, do të jetë një barrë e rëndë për të dyja palët.

Uroj përzemërsisht të gjithë nxënësit e Shqipërisë, në veçanti ata që ulen për herë të parë në bankat e shkollës!

Gjithashtu një urim i përzemërt shkon edhe për të gjithë nxënësit e institucioneve arsimore të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, nxënësit e Medreseve.

Profetët janë mësuesit e mëdhenj të njerëzimit, ata nuk na lanë pas pasuri, por na lanë trashëgim dituri të dobishme.

Ta mbajmë gjallë dhe ta çojmë përpara këtë trashëgimi të paçmueshme! Pa dyshim, rol parësor në jetën e fëmijëve luajnë prindërit, edhe për ta kjo është një ditë po aq e rëndësishme dhe e veçantë.

Së bashku me djaln tim, Seadin, ju urojmë suksese të gjithëve!”



Kryetari Spahiu pret në një takim Nuncin Apostolik në Shqipëri

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, pret në një takim lamtumire Nuncin Apostolik në Shqipëri, imzot Charles John Brow.

Duke e falënderuar diplomatin për kontributin e tij në forcimin e marrëdhënieve dypalëshe gjatë periudhës që ai ka shërbyer në Shqipëri, z. Spahiu tha se ne i kushtojmë shumë vëmendje rritjes së bashkëpunimit dhe harmonisë ndërfetare në vend. Gjithashtu kryetari i KMSH-së, e falënderoi Nunc Brow-in për kontributin e tij në këtë drejtim.

Nunci Apostolik Brow, vuri në dukje se shërbimi diplomatik në Shqipëri ka qenë një kënaqësi e veçantë dhe vlerësoi ngrohtësinë dhe bashkëpunimin dypalësh me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.

Ai veçoi kontributin e z. Spahiu në cilësinë e Kryetarit të KMSH-së, veçanërisht në funksion të forcimit të bashkëpunimit dhe dialogut ndërfetar në Shqipëri.



Drejtoresha e (CVE), znj. Leidi Dervishi, viziton KMSH-në

Kryetari i Komuniteti Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim znj. Lejdi Dervishi, Drejtoreshë e Qendrës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri.

Kryetari Spahiu i uroi znj. Dervishi mirëseardhjen dhe shprehu vlerësime për punën e bërë deri më tani nga Qendra CVE.

“Ashtu sikurse edhe ka ndodhur deri më tani, institucioni që unë përfaqësoj do të jetë bashkëpunues në nisma të tilla, të cilat kanë për qëllim kontributin për paqe, dialog dhe harmoni midis individëve dhe komuniteteve në rang kombëtar dhe më gjerë” - tha kryetari Spahiu në fjalën e tij.

Znj. Dervishi u shpreh e kënaqur nga bashkëpunimi i deritanishëm me KMSH-në dhe vlerësoi gjithashtu rolin tepër pozitiv që luan Komuniteti Mysliman në shoqërinë shqiptare.



Vizitë pune në myftininë e Gjirokastrës

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, gjatë një vizite pune në Myftininë e Gjirokastrës.

Në këtë vizitë, kryetari Spahiu, zhvilloi një bisedë pune me myftiun e Gjirokastrës dhe imamët e kësaj myftinie, si dhe mbajti hutben e xhumasë në xhaminë e “Pazarit”.

Gjatë kësaj vizite, kryetari Spahiu, u shoqërua nga Kancelari, z. Ylli Cikalleshi dhe Drejtori i Vakf Investimeve, z. Edison Hoti.









Ambasadorja e SHBA-së në Tiranë viziton KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H.Bujar Spahiu, priti në një takim Ambasadoren e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Yuri Kim.

Kryetari Spahiu i uroi mirëseardhjen ambasadores dhe shprehu vlerësimin për marrëdhëniet e deritanishme ndërmjet institucionit që ai drejton dhe Ambasadës së SHBA-së në Shqipëri.

Ambasadorja Kim, shprehu vlerësimin maksimal për lidhshypin që ka treguar Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në mbajtjen larg të institucionit nga influenza, të cilat bien ndesh me misionin hyjnor të islamit si fe e paqes dhe harmonisë. Ambasadorja garanoi mbështetjen e saj personale dhe të shtetit të cilin përfaqëson, ndaj institucionit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Të pranishëm në takim ishin edhe Kancelari i KMSH-së, z. Ylli Cikalleshi si dhe Drejtori i Mardhënieve me Jashtë, z. Fejzi Shaholli.







Kryetari i KMSH-së, vizitë pune në myftininë e Shkodrës

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë H. Bujar Spahiu, Kancelari, z. Ylli Cikalleshi dhe Drejtori i Vakf Investimeve, z. Edison Hoti, gjatë një vizite në Myftininë Shkodër.


Vizita ishte në kuadër të përkujtimit të ditëlindjes së Profetit Muhamed (a.s).

Kryetari Spahiu, mbajti edhe hutben e ditës së xhuma në xhaminë e “Parrucës”, nga ku ndau me besimtarët e qytetit verior rëndësinë e mesazheve të paqes, bashkimit dhe harmonisë midis besimtarëve, por edhe midis nesh si shqiptarë me njeri-tjetrin, pa dallime.

Ndërsa biseda me Myftiun e Shkodrës, z. Muhamed Sytari, u përqëndrua te aktivitetet fetare dhe ecuria e punës në këtë myftini.









Zhvillohet trajnimi i 43 imamëve pranë Universitetit të Ez'herit

Me iniciativë të Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H.Bujar Spahiu, u bë e mundur trajnimi i 43 imamëve, predikues e mësues fetarë shqipfolës nga shtete të ndryshme të Ballkanit, pranë Universitetit të mirënjohur al- Ez'her të Egjiptit.

Trajnimi u zhvillua “online”, organizimi dhe menaxhimi i të cilit u krye nga Organizata Ndërkombëtare e të Diplomuarve në al- Ez'her.

Ky trajnim u zhvillua nën kujdesjen e veçantë të Shkëlqesisë së Tij, Imamit të Madh të Ez'herit, Prof. Dr. Ahmed al-Tajib.

Në prani të përfaqësuesve të lartë të institucionit organizator, kryetari Spahiu falënderoi përzemërsisht shkëlqesinë e tij, Imam al-Tajib për këtë cikël trajnimi në veçanti, dhe për përpjekjet e vazhdueshme të tij dhe të Universitetit të Ez'herit në fushën e përhapjes së mesazhit të saktë e të pa deformuar të fesë islame.



Profeti Muhamed (a.s), Krenaria e Njerëzimit

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë zhvilloi programin fetar me lexim Kurani, ligjërata, dua dhe ilahi kushtuar Profetit Muhamed (a.s), në xhaminë e “Kokonozit”.

Programi u hap me leximin e disa ajeteve Kuranore nga Hafizi Enes Hyka, për të vazhduar më pas me fjalën përshëndetëse të Myftiut të Tiranës, z. Lauren Luli, i cili pasi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, u ndal në rëndësinë e organizimit të aktiviteteve të tilla në rifreskimin e besimit.

Më tej, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, ndau me të pranishmit dhembshurinë dhe mëshirën e Profetit Muhamed (a.s), duke e ilustruar fjalën e tij me shembuj të shumtë nga jeta profetike.

Menjëherë pas tij, fjalën e mori Nënkryetari, z. Taulant Bica, i cili referoi mbi rëndësinë e të qenurit ummet i Muhamed Mustafasë, sipas porosive dhe shembullit të jetës së vetë Profetit (a.s).









Angazhimi i të rinjve për një komunitet të qëndrueshëm

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në bashkëpunim me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, lançuan fazën e dytë të projektit, me temë: “Angazhimi i të rinjve për ndërtimin e një komuniteti të qëndrueshëm”.

Ceremonia e hapjes së këtij projekti, e cila u zhvillua në ambientet e “Hotel Tirana” dhe nëpërmjet platformës virtuale “zoom”, mbledhi së bashku, Kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Ambasadoren e SHBA-së, Yuri Kim, Zv. Ministren e Brendshme, Romina Kuko, Drejtoreshën e Qendrës Kombëtare Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, znj. Lejdi Dervishi, Myftiun e Tiranës, z. Lauren Luli si dhe z. Ian Crawford, Oficer për të Drejtat e Njeriut pranë Ambasadës së SHBA-së.

Në fjalën e tij, Kryetari i KMSH-së, z. Spahiu, veçoi radikalizmin e dhunshëm dhe ekstremizmin si sfidat kryesore për paqen dhe sigurinë në botë.







Hutbeja e Lirisë

Në kuadër të kremtimit të 30-vjetorit të lirisë së besimit, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H.Bujar Spahiu, mbajti hutben në xhaminë e “Plumbit”, Shkodër, 30 vite pas rikthimit të lirisë së besimit në Shqipëri.

Një nga komponentët më të rëndësishëm të lirisë së njeriut, është liria për të besuar, theksoi kryetari Spahiu në hutben tij përpara besimtarëve të shumtë që morën pjesë në faljen e xhumasë në xhaminë e “Plumbit”.

Ai i bëri thirrje rinisë për të rritur shkallën e njohjes së të shkuarës, me qëllim që ajo të mos përsëritet më kurrë.









Përrurimi i kompleksit dhe xhamisë në lagjen “Kiras”, Shkodër

I pranishëm në këtë ceremoni inaugurimi, ishte Nënkrjetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica.

“Xhamitë janë vatër edukimi në të cilat kultivohet dashuria ndaj Allahut (xh.sh), nisur nga kjo uroj dhe shpresoj shumë që besimtarët e kësaj lagjeje por edhe të të gjithë qytetit të Shkodrës, t’i japin kësaj xhamie vlerën e vërtetë ku ushqehet mendja dhe shpirti me besim ndaj Krijuesit të Gjithësisë.” – tha z. Bica gjatë fjalës së tij.

Gjatë kësaj ceremonie përshëndetën gjithashtu edhe sekretari organizativ i myftinisë Shkodër, teologu Lavdrim Hamja, kryetarja e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi dhe drejtori për Ballkanin i “Komisionit për Evropën dhe dy Amerikat” në Kuvajt, Shejkh Mahmud En-Nexhdi.



Zhvillohet Panairi i bamirësisë nga Zyra e Gruas

Në shëtitoren “Murat Toptani” u zhvillua panairi i bamirësisë “Kënaqësia e Zotit është e fshehur në kënaqësinë e të varfërve dhe nevojtarëve”, organizim i Zyrës së Gruas pranë Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë.

Panairi u organizua në kuadër të aktiviteteve të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë me rastin e festave kombëtare të pavarësisë dhe çlirimit të vendit, 28-29 nëntorit.









Kryetari i KMSH-së viziton homologun e tij, ef. Shaqir Fetahu

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë gjatë vizitës zyrtare në Maqedoninë e Veriut, me rastin e ceremonisë së betimit të Kryetarit të Bashkësisë Islame në RMV, ef. Shaqir Fetahu.









Me të vërtetë, pas vështirësisë, vjen lehtësimi!

Komuniteti Mysliman, nëpërmjet Drejtorisë së Vakëf Investimeve/Financës dhe Myftinisë Tiranë, investuan donacionet e besimtarëve në ndërtimin e shtëpisë së z. Elmi Spahiu, në Ndroq.

Shtëpia e familjes, prej 5 anëtarësh, u shkatërrua plotësisht nga tërmeti.

Falë mbështetjes së qytetarëve u bë e mundur që kësaj familjeje t'i rindërtohej shtëpia nga e para.

Në momentin e dorëzimit të çelësave dhe dokumentacionit të shtëpisë, morën pjesë Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli, Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj, Drejtori i Vakf Investimeve dhe Financës, z. Edison Hoti dhe Prefekti i Tiranës, z. Toni Gogu.









Ambasadori i Polonisë, vizitë në KMSH

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim lamtumire Ambasadorin e Polonisë në Shqipëri, z. Karol Bachura.

Kryetari Spahiu, i shprehu atij vlerësimin për miqësinë që ka treguar ndaj Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe popullit tonë gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në Shqipëri.

Ambasadori Bachura, pasi shprehu kënaqësinë për misionin e tij në Shqipëri, si dhe për cilësinë e marrëdhënieve ndërmjet institucionit që ai përfaqëson dhe KMSH-së, shprehu edhe vlerësim të veçantë për kontributin që jep KMSH në harmoninë dhe dialogun fetar në Shqipëri, si një model tepër i çmuar.



Prefekti i Qarkut Tiranë, z. Toni Gogu, vizitë prezantimi në KMSH pas marrjes së detyrës

Ai u prit nga Kryetari Spahiu dhe Myftiu i Tiranës
Lauren Luli.

Kryetari Spahiu e uroi prefektin për marrjen e kësaj
detyre dhe i uroi atij suksese në përmbushjen e
përgjegjësiave.

Prefekti Gogu, pasi e falënderoi kreun e KMSH-së për
mikpritjen, vlerësoi kontributin e çmuar që Komuniteti
Mysliman i Shqipërisë jep vazhdimisht në shoqërinë
tonë për kapërcimin e situatave si rasti i tërmetit dhe
pandemisë dhe në çdo rast tjetër i cilësdo natyre
qoftë.







Kryetari i Bashkësisë Islame të RMV-së viziton KMSH-në

Kryetari i Bashkësisë Islame të RMV gjatë vizitës së tij të parë zyrtare, jashtë RMV pas marrjes së detyrës, viziton Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, ku u prit nga homologu i tij, H. Bujar Spahiu.







Përmbajtja

Zhvillohet trajnimi me temë: “Mirëdrejtimi dhe Marketingu për Zhvillimin e vakëfeve.....	8
Ambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë viziton KMSH-në.....	12
Mbledhja e parë e Bordit të Presidencës së Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë për vitin 2020.....	14
Kryetari i KMSH-së H. Bujar Spahiu viziton Myftininë e Vlorës.....	16
Myftiu i Elbasanit vlerësohet me titullin: “Mirënjohja e Qarkut Elbasanit”.....	18
Zyra e Gruas zhvillon mbledhjen e parë për vitin 2020.....	20
Kryetari i KMSH-së mban hutben në xhaminë e “Medresesë”, Tiranë.....	24
Zhvillohet konferenca rajonale me temë: “Vëllazëria njerëzore për promovimin e sigurisë dhe paqes”.....	26
Kryetari i KMSH-së, vizitë pune në Myftininë e Beratit.....	28
Frytet e Besimit zhvillohen në xhaminë e Pazarit të Ri, Tiranë.....	30
Kryetari Spahiu merr pjesë në aktivitetin e ditës së pavarësisë dhe të çlirimit të shtetit të Kuvajtit.....	32
Nënkryetari i KMSH-së mban hutben e xhumasë në xhaminë e qendrës, Fier.....	34
Ambasadori i Gjermanisë në Tiranë, viziton KMSH-në.....	36
Një delegacion i Bashkësisë Islame të Kosovës, viziton KMSH-në.....	38
Islami dhe sfidat e familjes në shoqërinë bashkëkohore.....	42
Zyra e Gruas organizon program festiv për 7 marsin 2020.....	46
Kreu i KMSH-së zhvillon një bashkebisedim online me Ambasadoren e SHBA-ve.....	52
Mbarë besimtarët myslimanë falin Fitër Bajramin.....	58
Kreu i KMSH-së pret në takim ambasadoren e Greqisë.....	62
Kreu i KMSH-së pret në takim përfaqësuesit e tarikateve.....	66
Kreu i KMSH-së pret në takim përfaqësuesin zyrtar të Tarikatit Halveti.....	70
Besimtarët myslimanë festojnë Kurban Bajramin.....	72
Inaugurohet xhamia e re e fshatit Banaj, Berat.....	78
Inaugurohet qendra kulturore fetare në Lushnje.....	82
Kryetari i KMSH-së vlerësohet me certifikatë mirënjohjeje nga Bashkia Lushnje.....	86
Inaugurohet restaurimi i Xhamisë së Peqinit.....	88
Zhvillohet simpoziumi ndërkombëtar: “Roli i Institucioneve Bamirëse në Promovimin e Paqe Sociale”.....	92
Qëllimet e larta të paqes në Islam.....	94
Roli i Tolerancës Fetare në parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.....	98
Inaugurohet fillimi i punimeve të xhamisë së re të Saukut.....	102
Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë uron vitin e ri shkollor 2020-2021.....	106
Kryetari Spahiu pret në një takim Nuncin Apostolik në Shqipëri.....	110
Kryetari Spahiu pret në një takim znj. Leidi Dervishi, Drejtoreshë e (CVE).....	112
Vizitë pune në myftininë e Gjirokastrës.....	114
Ambasadorja e SHBA-së në Tiranë viziton KMSH-në.....	118

Kryetari i KMSH-së, vizitë pune në myftininë e Shkodrës.....	122
Zhvillohet trajnimi i 43 imamëve pranë Universitetit të Ez'herit.....	126
Profeti Muhamed (a.s), Krenaria e Njerëzimit.....	130
Angazhimi i të rinjve për një komunitet të qëndrueshëm.....	134
Hutbeja e Lirisë.....	138
Përurimi i kompleksit dhe xhamisë në lagjen “Kiras”, Shkodër.....	142
Zhvillohet Panairi i bamirësisë nga Zyra e Gruas.....	144
Kryetari i KMSH-së viziton homologun e tij ef. Shaqir Fetahu.....	148
Me të vërtetë, pas vështirësisë, vjen lehtësimi!.....	152
Ambasadori i Polonisë vizitë në KMSH.....	158
Prefekti i Qarkut Tiranë, z. Toni Gogu vizitë prezantimi në KMSH pas marrjes së detyrës.....	160
Kryetari i Bashkësisë Islame të RMV-së viziton KMSH-në.....	164

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Aktivitete 2020 / red. Hysni Gurra,
Erzen Carja, KMSH.

- Tiranë:Komuniteti Mysliman i
Shqipërisë, 2021

172 f. : me foto; 20x20cm.


ISBN 978-9928-194-87-9

1.Feja islame

2.Institucione fetare

3.Shqipëri

28-736(496.5) “2020”



www.kmsh.al

